Procesverbali 01/2020

I mbajtur me datën 02.04.2020 në mbledhjen e I -rë të jashtëzakonshme të KK-së në teatrin e qytetit ;, Adriana Abdullahu'', e udhëhequr nga Kryesuesja e KK-së, znj. Kristina Gashi Bytyçi, të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës z.Agim Aliu, Nënkryetari Komunës për Komunitete z. Florim Bajrami, Drejtorët e drejtorive të komunës dhe mediat.

Mbledhja filloi në ora10,15 h.

Kryesuesja e KK-së – znj. Kristina Gashi Bytyçi - Po e fillojmë seancën e I të jashtëzakonshme të KK-së, me këtë rend të ditës.

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Propozim – Vendim për ndarjen e mjeteve në shumën prej 200.000 euro në mbështetje të luftës kundër pandemis COVID-19;

Pika: 1

Konfirmimi i pjesëmarrjes së anëtarëve në mbledhjen e KK-së

Kryesuesja e KK-së – znj. Kristina Gashi Bytyçi - Prezent ishin 36 anëtarë të KK-së.

Pika: 2

Miratimi i rendit të ditës.

Kryesuesja e KK-së – znj. Kristina Gashi Bytyçi – Rendi i ditës u miratua një zëri nga gjithë të pranishmit.

Pika: 3

Propozim – Vendim për ndarjen e mjeteve në shumën prej 200.000 euro në mbështetje të luftës kundër pandemisë COVID-19;

z.Agim Aliu – I falënderoi Ferizajasit për punën, kujdesin angazhimin e pa shoqë nga mjekët, qytetarët, gazetarët, bukëpjekësit, biznesmenët e qytetarët si heronjë të kohës. Synojmë të bëjmë më të mirën e mundshme për të parandaluar pandeminë dhe për ta kaluar gjendjen. Më tej Kryetari radhiti masat e ndërmarra nga qeveria komunale duke mbimarrë veprime konkrete, ndërprerjen e mësimit, zgjatjen e kujdestarisë në shëndetësi, sanksione për rritjen e çmimeve në treg, dezinfektimi i hapësirave publike, vendosëm mbylljen e tregjeve, frekuentimin e parqeve dhe shëtitjet në to, dezinfektimi i xhamijëve, mbylljen e bizneseve si motelet, baret, kafiteritë, qendrat tregtare, trajtimi i rasteve të dyshimta, shtimin e kujdesit ndaj hedhjes së mbeturinave, reduktimi i stafit komunal. 89 qytetarë u vetë izoluan u sigurua ujë i mjaftueshëm për pije, u dezinfektuan afro 50banesa të vjetra. Ferizajasi i parë i infektuar u izolua menjëherë dhe prandaj nuk kemi asnjë ferizajas të infektuar aktualisht. Janë mbledhur rreth 200 pako për familjet

skamnore, u dakorduam me furrtarët që gjitha familjet të furnizohen me nga nje bukë falas në ditë.
Ferizajasit po tregohen të kujdesshëm , asnjë vendim i qeverisë nuk është shkelur. Qeveria komunale do të jetë në vazhdimësi pranë qytetarëve. Faleminderit që keni ardhur këtu. Le të vazhdojmë këtë betejë deri në fitore.
znj.Kristina Gashi Bytyçi- Kryesuese e Kuvendit të Komunës- I nderuar kryetar I komunes se Ferizajt z.Aliu, nenkryetar per komunitete z.Bajrami, te nderuar drejtor te drjtorive, anetare te KK-se, medie, OJQ dhe te gjithe te pranishem
Kuvendi i komunës së Ferizajt solidarizohet me të gjithë qytetarët e komunës së Ferizajt, e kjo deshmohet edhe me seancen e sotme te jashtzakonshme e cila eshte pikerisht per ndarjen e mjeteve financiare te propozuara nga kryetari z.Aliu, ku dje ne mbledhjen e KPF-se u perkrahe ky propozim nga te gjithe anetaret te cilet jane pothuajse nga te gjitha partit politike te perfaqesuara ne Kuvend te Komunes. Sot me shume se kurre duhet te jemi nje, dhe te perkrahim njeri-tjetrin dhe te gjitha familjet ne nevoje me nje qellim te perbashket, ta tejkalojme kete gjendje jo të favorshme për ne sa me mire, kur e dijmë që rastet e prekura nga COVID-19 po shtohen në botë, e fatkeqësishtë edhe në Republikën e Kosovës.
Fatmirësisht në komunën e Ferizajt deri më tani nuk kemi asnjë rast, duke ju falenderuar qytetarëve për mobilizim për t'u vetizoluar, për të shmangur kontaktet me njëri tjetrin dhe duke ju përmbajtur të gjitha udhëzimeve të propozuara nga institucionet e Republikës së Kosovës. Mbështesim dhe falenderojmë të gjithë stafin shëndetësorë, institucionet lokale përkatësisht shtabin emergjent dhe kreun e komunës së Ferizajt z.Aliu, të cilët qe nga fillimi, para se te mirren vendime ne Qeverine e Kosoves, kane marre masat dhe jane në gatishmëri për t'i dal ball kësaj sfide në të cilën gjindemi për parandalimin e kësaj pandemie.
Një falenderim i veqantë për mantelbardhët, Policinë e Kosovës, kompanite publike dhe gazetarët të cilët janë në krye të detyrës, përderisa ne jemi duke qëndruar në shtëpite e tona, ashtu siq na kanë rekomanduar.
Anëtarët e Kuvendit të komunës së Ferizajt, në çdo situatë deri më tani kan treguar solidaritetin dhe mbështetjën për qytetarët në nevojë. Edhe këtë herë z.Lulzim Abazi i ka dhuruar QKMF-së dy aparate për prodhimin e oksigjenit me pajisje përcjellëse, të cilin e falenderojmë për kontributin e tij mjaft të nevojshëm për trajtimin e pacientëvë, sidomos tani kur përballemi me këtë gjendje, gjithashtu Lulzim Grainca me shume biznese te tjera vazhdimisht jane ne teren duke ndihmuar familjet ne nevoje e sidomos ato me asistence sociale me pako ushqimore e higjienike dhe me miell.
Andaj, sot bashkarisht po bejme nje hap te mire dhe shume te rendesishem per komunen tone e cila eshte shembull per menagjimin e kesaj sfide me pandemine COVID-19, duke perkrahur kete propozim, dhe duke hapur rrugen tutje per perkrahjen e te gjithe qytetareve per te perballuar me lehte kete gjendje. Ju faleminderit.
z.**Xhevat Sallahu -** i cili i ofroi mbështeje për ndarjen e mjeteve në luftimin e pandemisë si dhe përkrahje për masat e ndërrmarra.
znj.Yllka Neziri- Falënderime për ata që po punojnë në luftimin e pandemisë, i ftoi që të jenë bashkë në këtë kohë pandemie dhe ofroi mbështetje si dhe përkrahi masat që janë ndërrmarrë, falënderoi kompaninë Pastërtia si dhe qytetarët për kujdesin.
z.Arian Imeri- Ofroi përkrahje si PDK për masat komunale dhe mbështetjen financiare. Falënderoi personelin mjekësor, për veprimet institucionale në përballimin e gjendjes.
znj.Bahrije Hyseni-Mbështetje për mbledhjen, ajo njoftoi se i biri i saj ishte i infektuar me virus dhe se ai nuk kishte qenë fare në shtëpi, është dhënë lajm i rrejshëm se fshati Bibaj është i

infektuar. Kjo dezinformatë ka dalë nga njerëz të komunës, dhe se askush nuk më ka kontaktuar për të verifikuar të vertetën, as kryetari nuk më ka kontaktuar . I mbështeti ndihmat për njerëz në nevojë.

Kryetari i Komunës- z. Agim Aliu- reagoi duke shprehur keqardhje për rastin dhe tha se ky rast nuk do duhej ti shërbente për mllef. Theksoi se/ kam kontaktuar me familjar tuaj dhe se ka qenë një keqkuptim në hallakat e institucioneve. Nuk ka qenë faj i yni e as përgjegjësia.Ky rast është sqaruar.

Nënkryetari për Komunitete- z.Florim Bajrami- Falënderoi të gjithë ata që po marrin aktivitete mbi luftimin e virusit dhe shfaqi mirënjohje për policinë, mantelbardhët, mjekët dhe qytetarët. Shprehi bindjen se të bashkuar do ja dalim mbanë, falënderoi gazetarët dhe kompaninë Pastërtia.

z.Amir Rexhepi- Falenderime për ata që janë në ballë të luftës me pandeminë. Kërkoi që të shikohet mundësia e ndihmës së kompanive publike.

z.Xhavit Zariqi – Nuk kam pritur se do të ketë shumë diskutime por e falënderoj Kryetarin z.Aliu për masat e ndërmarra, është mirë që nuk kemi përhapje të madhe të pandemisë në Ferizaj. Shuma e propozuar është simbolike, por në përputhje me mundësitë. Duhet të jemi të përshtatshëm edhe më tej ti mbështesim punëtorët. Sipas nevojës të heqim ndonjë projekt dhe mjetet ti përdorim për luftimin e pandemisë. Faleminderime për punëtorët që janë treguar të përgjegjshëm dhe bashkëpunues. Propozoj që të shqyrtohet mundësia e rishqyrtimit të programeve në mënyrë që të kemi mjete financiare në dispozicion. Unë e mbështes propozimin për ndarjen e këtyre 200.000 eurove.

znj.Evetare Azemi – Nuk është koha për shumë fjalë por për shumë punë. Suksesi në kohë pandemie është tek bashkëpunimi i të gjithëve. Ne jemi që të bashkëpunojmë me shtabin emergjent. Faleminderime për të gjithë ata që po angazhohen në këtë kohe.

znj.Hatixhe Bungu Qerimi – Prania jonë ketu tregon solidaritetin me familjet Ferizajase. Përgëzime për Krytearin z.Aliu dhe stafin e tijë për menagjim të mirë të situatës. Propozoj një komision me nga një përfaqësues nga subjektet politike dhe komunitetet për menagjimin e situatës tek familjet me gjendje të rëndë ekonomike si dhe për menagjimin e shumës së propozuar. Urojë që të gjitha përpjekjet tona të rezultojnë me sukses. Kjo ndihmë e propozuar do ti ndimojë shumë familje.

znj.Hysnije Mustafa Shamolli – Shpreh shqetësimet që pandemia po shfrytëzohet për promovim politik. Përgëzoi Kryetarin si dhe të gjithë ata që po luftojnë kundër kësaj pandemie. Falenderoj pikërisht nxënësit dhe të gjithë mësimdhënësit për angazhimin rreth mësimit online.

z.Gëzim Kokollari – Potikën këtu e filloi Kryetari që nuk e ceku se e kujt ishte nisma për këtë ndihmë. Nuk u tregua se si do të ndahet kjo shumë financiare. Stafi shëndetësor më nuk ka nevojë për falënderime por ka nevojë për mjete. Le të ndahen edhe 200.000 euro të tjera për stafin mjekësorë që nuk janë të angazhuar përmes Caritasit.

z.Burim Karameta – Falenderoi Kryetarin dhe të gjithë që po kontribuojnë si Lulzim Graica e Lulzim Abazi. Kërkoi që të mos harrohen edhe më vonë ata që u angazhuan si mjekët, infermierët që janë gjithmonë në ballë. Faleminderoj këmbënguljen e Amir Rexhepit, Yllka Nezirit dhe Hysnije Shamolli Mustafa për nismën për këtë shumë.Kërkoi nga Kryetari dhe kolegët që të shtohet shuma për të ndihmuar stafin mjekësor dhe familjet në nevojë. Të ketë edhe shuma tjera që të shpërndahen për ushqim.

Drejtori i drejtorisë së Shëndetësisë z. Bekim Ademi – Në aspektin shëndetësorë Komuna e Ferizajt po qëndron më mirë se komunat e tjera. Gjeturia jonë dhe donatorët kanë ndihmuar për këtë gjendje. Punëtorët shëndetësorë kanë marrë doreza dhe maska. Para pak ditësh janë paguar

dy paga dhe së shpejti do të paguhen edhe një pagë tjetër për punëtorët e angazhuar nga Caritasi. Ju ftoj të gjithëve për bashkëpunim të ngushtë. Besojdo tia dalim.

z.Arian Imeri – Tha se nuk ka nevojë të politizohen këto mjete. Nuk ka nevojë për komisione pasi është shtabi. Mundësitë financiare janë këto dhe aktualisht nuk mund të shtojmë shuma të tjera.

z.Lulzim Abazi - Ferizaj, Kryetari, drejtorët, shtabi emergjent po tregohen në lartësinë e detyrës për menaxhimin e situatës. Shuma e propozuar është e rëndësishme. Ferizaj ka treguar se di të jetë unik në situatë si kjo, numri i të infektuarave është rezultat i menaxhimit të mirë. Falënderime për të gjithë ata që u angazhuan.

znj.Hatixhe Bungu Qerimi- Kuvendi ka të drejtë të dijnë se ku shkojnë këto mjete.

z.Gëzim Kokollari – Do të doja që të gjitha propozimet të hidhen në votim. Propozimet nuk janë fontanë dëshirash por nevoja. Është ligjore që të shtohen 5% të investimeve kapitale për nevoja emergjente.

znj.Kristina Gashi Bytyci- Kryesuese e Kuvendit të Komunës – Sipas ligjit për vetë qeverisje lokale duhet të përcaktohemi vetëm për propozimin e rendit të ditës.

z. Arian Imeri – Më pas do të kemi raporte se si janë shpenzuar këto mjete dhe në këtë mbledhje nuk duhet të ketë shuma tjera shtesë, nese vërtetë do ta përkrahni egzektutivin këto janë mundësit financiare të tyre.

Kryetari i Komunës z.Agim Aliu – Të gjitha diskutimet kishin një qëllim, që ta përballojmë sa më mirë situatën. Investimet kapitale janë më pak se 15.000.000.00 miljonë. Ne mund të takohemi prap dhe të vendosim për propozime të reja. Kryetarët e Komunave kemi kërkuar që MF ti miratojë mjetet pa vendim të KK-së, por nuk është lejuar. Prandaj mund të takohemi sërish për vendime të reja. Kemi zotime për fond prej 10.000.00 milojnë por edhe nuk dihen hollësitë. Këto mjete prej 200.000.00 euro do të përdoren në mënyrë transparente dhe nuk ka nevojë për komisione. QPS dhe DSHMS e dinë më së miri gjendjen e familjeve në nevojë. Kemi mbështetje të madhe nga bizneset, kompanitë publike duhet të mbështeten nga Ministrië e Linjës. Kompania Pastërtia po shquhet për punë të madhe por nuk janë futur në pakon emergjente. KRKP na ka miratuar procedurat e negocimit për masat mbrojtëse shëndetësore edhe njëherë falënderime për të gjithë ju. Le të kontribuojmë javët e ardhshme me angazhime shtesë që të vazhdojmë shembullin e mirë të deri tanishëm, le të qëndrojnë qytetarët në shtëpi.

znj.Kristina Gashi Bytyci- Kryesuese e Kuvendit të Komunës – E hedh në votim propozim vendimin për ndarjen e mjeteve në shumën prej 200.000 euro në mbështetje të luftës kundër pandemis COVID-19, dhe të gjithë janë Pro.

Procesmbajtësi

Musli Berisha

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Kristina Gashi Bytyçi